



Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë, 15.09.2016

## LETËR E HAPUR

**Drejtuar:** Z. Erjon Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë

**Për dijeni:** Z. Blendi Klosi, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë  
Zj. Etleva Bisha, Drejtore e Shërbimit Social Shtetëror  
Zj. Eglantina Gjermeni, Ministër e Zhvillimit Urban  
Z. Arben Ahmetaj, Ministër i Financave

**Lënda:** *Planifikimi i pikave të mëposhtme në buxhetin e vitit 2017 si detyrim ligjor i Njësitve të Qeverisjes Vendore/ Bashkive për:*

- Ngritjen/Mirëfunksionimin e Mekanizmit të Bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje dhe vendosja e Koordinatorit për Dhunën në Familje në çdo bashki (aty ku nuk ka);
- Krijimin i një Strehëze Emergjence (Shelter) pranë çdo bashkie si pjesë e detyrimeve të pushtetit vendor;
- Përfshirjen nga taksat për gratë kryefamiljare të papuna; me të ardhura nën minimumin jetik; të mbijetuara të dhunës në familje; ish viktime të trafikimit; apo të tjera gra vulnerabël;
- Përfshirjen e grave kryefamiljare të papuna; me të ardhura nën minimumin jetik; të mbijetuara të dhunës në familje; ish viktime të trafikimit; apo të tjera gra vulnerabël, në grupin e përfituesve në programet sociale të strehimit.

I/E nderuar Z.Zj. \_\_\_\_\_

### Baza Ligjore:

- Ligji nr.104/2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës”, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”;
- Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në mbështetje të nenit 8, nenit 9, neni 24; nenit 35 dhe nenit 54, pikat 1, shkronja “f”;



- Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar;
- Ligji nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar;
- Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar;
- Ligji nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji nr.9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 23, datë 30.12.2008 “Për Përmbajtjen e Bonusit të Strehimit”;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);
- Ligji nr.115/2014, “Për ndarjen administrative–territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM nr.334 datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij”;
- VKM nr. 658, datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve shoqërore”;
- VKM nr. 505, datë 13.07.2011 “Për Standartet e Shërbimeve Të Përkujdesit Shoqëror për Viktimat e Dhunës në Familje” në Qendrat Rezidenciale Publike dhe Jopublike”.

Dhuna në Familje dhe Dhuna me Bazë Gjinore është një fenomen global dhe prek të gjitha shtresat e popullësisë, pavarësisht moshës, nivelit të arsimimit, statusit, kombësisë, klasës, racës, gjinisë apo etnisë. Dhuna në Familje dhe Dhuna me Bazë Gjinore mbetet një shqetësim i madh në Shqipëri, si një nga format më serioze dhe të vazhdueshme të shkeljes të të drejtave të njeriut në vend, sidomos të vajzave e të grave. Është e domosdoshme që shteti të ndërmarrë nismat e duhura kundër këtij fenomeni në mënyrë që të respektojë dhe plotësojë të drejtat themelore të grave dhe fëmijëve si pjesë e të drejtave të njeriut.

Konventa e Stambollit e njeh dhunën ndaj grave si shkelje e të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi kundër grave, e cila nënkupton të gjitha format e Dhunës me Bazë Gjinore. Me Ligjin nr.104/2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës”, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familja”, shteti shqiptar ka treguar gadishmërinë e tij për të përmbushur detyrimet që burojnë nga kjo Konventë. Një nga detyrimet e shtetit në kuadër të kësaj Konvente është dhe rehabilitimi dhe fuqizimi i grave viktime të dhunës në familje.

Për këto arsye, *Rrjeti për Fuqizimin e Gruas në Shqipëri – AWEN dhe 9 organizatat e tij anëtare*, kërkojmë nga pushteti vendor të merren në konsideratë kërkesat e listuara si më poshtë në



mbështetje të grave viktime të dhunës në familje, në zbatim të Konventës së lartpërmendur dhe legjislationit të brendshëm që është në fuqi.

- 1. Ngritjen dhe mirëfeksionimin e Mekanizmit të Bashkërendimit të Punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe caktimin e Koordinatori Vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare (aty ku nuk ka);<sup>1</sup>**

Ky mekanizëm nuk është funksional dhe gjithëpërfshirës në çdo bashki ku punojnë organizatat e AWEN, ndaj lind nevoja që ligji të ushtrojë kompetencat e tij sikurse parashikohen në VKM për referimin dhe menaxhimin e rasteve.

- 2. Krijimi i një Strehëze Emergjence<sup>2</sup> për strehimin e viktimave deri në pajisjen me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje.**

Bazuar në standardet minimale ndërkombëtare duhet që për çdo 10 000 banorë të këtë një shtret dhe referuar të dhënave për popullsinë të Instat, Shqipëria duhet të ketë 283 shtretër. Në Komisaritet e Policisë, ambientet ku priten viktimat e dhunës dhe plotësohet dokumentacioni për rastin e tyre janë të papërshtatshme.

Ekziston një vakum ligjor i cili nuk siguron mbrojtjen e nevojshme për viktimat e dhunës në familje për periudhën e 48 orëve menjëherë pas referimit të rastit të dhunës.

- 3. Përrjashtimin nga taksat për gratë kryefamiljare të papuna; me të ardhura nën minimumin jetik; të mbijetuara të dhunës në familje; ish viktime të trafikimit; apo të tjera gra vulnerabël, etj.**

Përrjashtimin nga taksat kombëtare sipas ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 i ndryshuar.

---

<sup>1</sup> Mbështetur në VKM, Nr. 334 të datës 17.2.2011, bazuar në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006.

<sup>2</sup> Konventa e Stambollit neni 23 “Palët marrin masat e nevojshme legjislativë ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e strehave të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme e në numër të mjaftueshëm, për të ofruar strehim të sigurt dhe për të përdorur përfaqje proaktive ndaj viktimave, veçanërisht grave dhe fëmijëve të tyre”. Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar; Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”.



këto kategori të përjashtohen nga pagimi i taksës së akteve dhe taksave që vilen nëpërmjet pullës dhe të përjashtohen nga pagesa e tarifave të shërbimit (neni 11/1 i ligjit).

Në mbështetje të ligjit për “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 35 pika 2, Bashkitë kanë të drejtë të përjashtojnë nga pagimi i taksës kategori të caktuara apo grupe në nevojë.

**4. Përfshirjen e grave kryefamiljare të papuna; me të ardhura nën minimumin jetik; të mbijetuara të dhunës në familje; ish viktimat të trafikimit; apo gra të tjera vulnerabël, në grupin e përfituesve në programet sociale të strehimit;**

Bashkitë janë përgjegjëse për administrimin e kërkesave për strehim social dhe përcaktimin e grupeve që do të kenë përparësi. Këshilli bashkiak miraton sistemin e vlerësimit me pikë. Sistemi i vlerësimit me pikë është krijuar për t'u dhënë përparësi grupeve në pozita të pafavorizuara. Është në diskrecion të Bashkive për të vendosur prioritet (d.m.th. t'u caktojnë pikë më të larta viktimat e dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit.) Kjo ndikon në probabilitetin e përzgjedhjes së tyre; sa më i lartë të jetë numri i pikëve aq më i madh është probabiliteti që ata të përfitojnë strehim social.

Sinqerisht,

Ines Leskaj  
Drejtoreshë Ekzekutive

**Në emër të:**

Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri – **AWEN**

Përbërë nga:

1. Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë;
2. Shoqata për gratë dhe vajzat me problem sociale, Durrës;
3. Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë;
4. Shoqata Unë Gruaja, Pogradec;
5. Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër;
6. Shoqata Agritra Vizion, Peshkopi;
7. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë;
8. Shoqata Forumi Gruas Elbasan;
9. Shoqata Jona, Sarandë.